



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-05

**Prokurori kundër Salih Mustafës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi-Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 18 mars 2022

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Urdhër për Parashtrime lidhur me Heqjen e Redaktimeve në Transkriptet e  
Seancave Gjyqësore ose Riklasifikimin e tyre**

---

**T'i njoftohet:**

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të të akuzuarit**

Julius von Bone

**Administratores**

Fidelma Donlon

**Mbrojtëses së viktimave**

Ani Pues

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues), më poshtë nxjerr urdhrin për parashtrime lidhur me heqjen e redaktimeve në transkriptet e seancave gjyqësore ose riklasifikimin e tyre.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 9 mars 2022, në përmbyllje të konferencës përgatitore të Mbrojtjes dhe konferencës për statusin e viktimave,<sup>1</sup> Trupi Gjykues, ndër të tjera, caktoi datat 21 mars 2022 dhe 22-23 mars 2022, si datat për të nisur paraqitjen e provave sikurse kërkohet prej mbrojtëses së viktimave dhe më pas paraqitjen e provave nga Mbrojtja e Salih Mustafës, përfshirë deklaratën hyrëse të Mbrojtjes.<sup>2</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

2. Trupi Gjykues merr për bazë nenet 21(2), 23, 40(2), dhe 43(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 80, 84(1) dhe 159(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).

## III. ANALIZË

3. Trupi Gjykues rikujton se, në pajtim me nenin 21(2) të Ligjit dhe në përputhje me masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat të urdhëruara në bazë të nenit 23 të Ligjit, në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën për gjykim publik. Gjithashtu, Trupi Gjykues rikujton se aktgjykimi do të shqiptohet

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-05, F00318, Trupi Gjykues I, *Vendimi i Tretë mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 9 shkurt 2022, publik, para. 16(c).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-05, Transkripti i seancës, 9 mars 2022, publik, p. 2520, rreshtat 2-7; f. 2522, rreshtat 2-11; f. 2524, rreshti 23 deri në f. 2525, rreshti 9.

publikisht, siç parashihet nga neni 43(2) i Ligjit dhe rregulla 159(2) e Rregullores. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses dëshiron të sigurohet që aktgjykimi që do të nxirret në bazë të nenit 43 të Ligjit, të jetë publik vetëm me redaktimet rreptësisht të domosdoshme, për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, në pajtim me nenin 23 të Ligjit.

4. Për organizimin e procesit gjyqësor në mënyrë efikase, duke respektuar në të njëjtën kohë parimin e procedurave publike dhe masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat, sipas nevojës, Trupi Gjykses e çmon të përshtatshme të urdhërojë palët, Zyrën Administrative (sipas rastit) dhe mbrojtësen e viktimave të bëjnë rishikimin e transkripteve,<sup>3</sup> ndër të cilat, pjesët që përmbajnë dëshmitë e dëshmitarëve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe të paraqesin konstatimet e tyre në një parashtrim të përbashkët nëse redaktimet ekzistuese mund të hiqen dhe/ose transkriptet mund të riklasifikohen si publike, sipas kalendarit më poshtë:

- Transkripti i seancës, 9 qershor 2021, f. 205 deri te transkripti i seancës, 14 tetor 2021, f. 1277, brenda **të premtës, 29 prill 2022**;
- Transkripti i seancës, 2 nëntor 2021, f. 1278 deri te transkripti i seancës, 18 nëntor 2021, f. 1717, brenda **të premtës, 27 maj 2022**;
- Transkripti i seancës, 22 nëntor 2021, f. 1718 deri te transkripti i seancës, 14 dhjetor 2021, f. 2025, brenda **të premtës, 24 qershor 2022**; dhe
- Transkripti i seancës, 18 janar 2022, f. 2026 deri te transkripti i seancës, 2 shkurt 2022, f. 2458, brenda **të premtës, 22 korrik 2022**.

---

<sup>3</sup> Në *Legal Workflow*, transkriptet ndahen sipas ditës së seancës. Transkripti në anglishte i ka faqet e numërtuara në vijimësi. Shih nenin 67 të *Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara në Dhomat e Specializuara të Kosovës*, KSC-BC-15 (17 maj 2019).

5. ZPS-ja, Mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave duhet të bashkëpunojnë me njeri-tjetrin për të dorëzuar propozime të përbashkëta lidhur me heqjen e redaktimeve në transkriptet e lartcekura apo propozuar riklasifikimin e këtyre transkripteve. Ftohet edhe Zyra Administrative të paraqesë konstatimet e veta lidhur me heqjen e redaktimeve/riklasifikimin e transkripteve, në parashtrimin apo parashtrimet e përbashkëta, në rast se ka pjesë në transkript që lidhen me rolin dhe funksionin e Zyrës Administrative. Në rast se palët, Zyra Administrative dhe/ose mbrojtësja e viktimave nuk pajtohen për pjesë të veçanta të redaktuara të këtyre transkripteve, atëherë duhet ta specifikojnë këtë në parashtrimin apo parashtrimet e përbashkëta për Trupin Gjykses, së bashku me arsyet për qëndrimet e ndryshme. Në fund, Trupi Gjykses vendos për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve në pajtim me rregullat 80(1) dhe 84(1) të Rregullores.

#### IV. VENDIM

6. Për arsyet e përmendura në lart, Trupi Gjykses **URDHËRON** palët, Zyrën Administrative dhe mbrojtësen e viktimave të kryejnë rishikimin e transkripteve, siç specifikohet në këtë urdhër, në përputhje me kalendarin e përcaktuar në paragrafin 4.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

*/nëshkrimi/*

---

**Gjykatës Zhilber Biti**

*/nëshkrimi/*

---

**Gjykatës Roland Dekers**

E premte, 18 mars 2022

Në Hagë, Holandë